



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 18.07.2024

PROCESVERBAL  
Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “Riaftësim strukturor i Pallatit nr.15, Rruga "Abaz Çelkupa 15", Rajoni 3, Kod GIS 24795”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):** Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV: Punë ndërtimi - 45000000-7

Në mbështetje të Ligjit Nr.97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e Ligjit, Nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”; Vendimit Nr. 225, datë 12.04.2021 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, të ndryshuar; Për këtë procedurë prokurimi u përdorën dokumentet standarde “Procedurë e përshpejtuar – rindërtimi punë”, lloji i procedurës “Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit) të konfirmuar nga Agjencia e Prokurimit Publik si më poshtë:

*Në lidhje me procedurat e prokurimit që zhvillohen në kuadër të procesit të rindërtimit, kuadri rregullator, përveç ligjit për prokurimin publik, përfshin Aktin Normativ nr. 9/2019, të miratuar me Ligjin 97/2019, si dhe VKM Nr.225 date 12.04.2021, me anë të të cilit janë miratuar dokumentet standarde të tenderit për këto procedura. Referuar këtyre dispozitave ligjore, hartimi i dokumentet standarde për procedurat e prokurimit për rindërtimin është kompetencë e Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin, ndërkohë që APP publikon këto dokumente.*

*Për sa më sipër, autoritetet kontraktore, për procedurat e rindërtimit, do të zbatojnë VKM Nr.225 date 12.04.2021 dhe do të përdorin dokumentet standarde të tenderit të miratuara me këtë vendim, edhe pse në këto DST nuk parashikohet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.*

**VLERA E FONDIT LIMIT TOTAL:** 81.831.881 (tetëdhjetë e një milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e një) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është 224 (dyqind e njëzet e katër) ditë.

---

Garancia per mbulimin te difekteve, qe mund te lindin gjate shfrytezimit te objektit, nga ana e firmes te jetë 2 vjet.

### **Argumentim:**

**MBI PËRLLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS SË PROKURIMIT ME OBJEKT:**

**“Riaftësim strukturor i Pallatit nr.15, Rruga "Abaz Çelkupa 15", Rajoni 3, Kod GIS 24795”**

Në zbatim të urdhrat të grupit të Specifikimeve nr. 220, datë 05.07.2024 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Vendimin të Këshillit të Bashkiak nr.195, datë 22.12.2023, “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2024”, si dhe në zbatim të Vendimit të Komisionit Shtetëror Rindërtimit nr.114, datë 16.04.2024.
2. Shqyrtoi dokumentet e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga projektuesi BOE “ARKONSTUDIO shpk”, “A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000 shpk”, “ERALD –G shpk” në bazë të Kontratës me Bashkinë Durrës me nr.661prot., datë 18.01.2021.

### **PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:**

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuara nga projektuesit BOE “ARKONSTUDIO shpk”, “A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000 shpk”, “ERALD –G shpk” dhe të miratuara nëpërmjet opionencave teknike në institutin e ndërtimit.

*Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e LigjitNr. 162 , datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 36.*

### **PËRLLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TE KONTRATËS**

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar sipas të cilit:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara

Në përfundim të punës së grupit u vërejt se: Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e paraqitur nga Projektuesit, BOE “ARKONSTUDIO shpk”, “A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000 shpk”, “ERALD –G shpk”,

---

dhe të miratuara nga Instituti i Ndërtimit për projekt zbatimin e objektit si dhe ne buxhetin e miratuar të Bashkisë Durrës.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se:

Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull: Riaftësim strukturor i Pallatit nr.15, Rruga "Abaz Çelkupa 15", Rajoni 3, Kod GIS 24795, rezultoi të jetë me vlerë: 81.831.881 Lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe përlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: "Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit", mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas *Shtojcës 3*; (Kjo shtojcë do paraqitet në fazën e II).
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas *Shtojcës 4*; (Kjo shtojcë do paraqitet në fazën e II).
- c. Sigurim oferte sipas *Shtojcës 5*; (Kjo shtojcë do paraqitet në fazën e II).
- ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas *Shtojcës 7*;
- d. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas *Shtojcës 8*;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës *Shtojcës 11*;
- e. Formular vlerësimi sipas *Shtojcës 12*;
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas *Shtojcës 13*;
- g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas *Shtojcës 14*;
- gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 77, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1. Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 10.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

---

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 81.000.000 lek.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

*Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.*

*Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

*Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

*AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të neneve 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

---

*Kërkesa për paraqitjen e bilnaceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

*Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40.500.000 Lek, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 162.000.000 Lek.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, *të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 12.*
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar referuar fondit limit, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është*

kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Aftësitë teknike dhe profesionale të tjerat si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga:** “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-2 B – Ndertime civile dhe industriale
- b. NS-1 A – Punime për prishjen e ndertimeve,
- c. NS-2 A – Impiante hidro-sanitare , kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre
- d. NS-4 B – Punime rifiniture të muratues dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.
- e. NS-14 A – Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV
- f. NS-3 A – Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

**Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve**

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-2 B	Ndertime civile dhe industriale	-Perforcim kolone betonarme -Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m <sup>3</sup> C25/30 -Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 25/30 ( Përfshire punimet të forimit të kollonave dhe traveve ekzistues dhe mbushje e	20-50 mln leke	<b>33,863,807</b> leke

		brimave ) -Kollona b/a monolite lidhese 20x20 cm C 25/30 h ~ 4m -Brez b/a monolit 20x15cm C 25/30, h ~ 8 m  -F V hekur betoni periodik Ø 6- 10 mm -F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm  -Soleta te plota b/a C 20/25 ( soleta dhe shkalle ) -F V hekur betoni periodik Ø 6- 10 mm -F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm -Mur me tulle me 8 vrima, t=10cm, h~3m, Ilaç perzier M15 -Mur me tulle me 8 vrima, t=20cm, h~3m, Ilaç perzier M15		
NS-1 A	Punime per prishjen e ndertimeve	-Prishje shtresa betoni -Prishje soleta b/a, shkalle b/a -Prishje mur tulle pa pastrim -Prishje suva ekzistuese muri -Prishje suva ekzistuese tavani -Prishje suva ekzistuese / veshje me kapot fasade -Transport materiale ndertimi deri ne 10km	0-20 mln leke	<b>3,489,603 Leke</b>
NS-2 A	Impiante hidrosanitare , kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre	F.V. Tub e rakorderi ujesjellesi PPR d=20mm, PN 16 F.V. Tub e rakorderi ujesjellesi PPR d=25mm, PN 16 F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PP-R , Ø32 X 4.4 mm PN 16 F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj.) F.V. Saracineska bronzi 3/4" F.V Pajisje hidrosanitare WC allafrenga importi F.V Pajisje hidrosanitare Lavaman porcelani importi me mishelator F.V Pajisje hidrosanitare bide me mishelator F.V Pajisje hidrosanitare pjate dushi me mishelator F.V Boiler elektrik 80 Lit F.V. Mini saracineska M/M 1/2 - 1/2 Shkarkimet ne planimetri te WC-ve F.V Tubo shkarkimi PP d110 F.V Tubo shkarkimi PP d50	0-20 mln leke	<b>5,574,391 Leke</b>

		<p>F.V Pilete dysHEMEJE d50</p> <p>F.V Tapa pastrimi Ø 110 mm</p> <p>F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj.)</p> <p>Kolonat e shkarkimeve dhe ventilimeve</p> <p>F.V Tubo shkarkimi PP d75</p> <p>F.V Tubo shkarkimi PP d110 kollone shkarkimi</p> <p>F.V Tubo shkarkimi PP d110 kollone ventilimi</p> <p>F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj.)</p>		
NS- 4 B	<p>Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.</p>	<p>-Shtrese lluster çimento 1:2 t = 50 mm</p> <p>-Hidroizolim ne nyje sanitare me dy shtresa mapej ose ekuivalente</p> <p>-Shtrese me pllaka gres importi ( ambiente + tualete)</p> <p>-Shtrim dhe Veshje shkalleve te brendeshme me pllaka mermeri t = 3cm</p> <p>-Plintuse pllake grez , h = 10 cm</p> <p>Suva e zakonshme fasade mur tulle h mbi 8 m</p> <p>-Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, llaç perzier M 25</p> <p>-Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me pompe</p> <p>-Veshje me pllaka (nyje sanitare)</p> <p>-Dritare d/alumini dyfish xham</p> <p>-F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I-re</p> <p>-Dyer te blinduara importi</p> <p>-Lyerje me boje hidroplastike (fasada .)</p> <p>-Lyrje me boje hidroplastike ( muret brenda )</p> <p>-Lyrje me boje hidroplastike ( tavanet )</p> <p>-Shtrese lluster çimento 1:2, mm</p> <p>-Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama</p> <p>-Shtrese lluster çimento 1:2, mm mbi hidroizolim</p>	20-50 mln leke	<b>31,555,540</b> Leke



NS-14 A	Impiante te brendshem, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV	-F.V. tuba plasmasi $\Phi$ 18-21 mm -F.V. tuba plasmasi $\Phi$ 22-26 mm -F.V. percjelles PV-500 $\Phi$ 1.5mm2 -F.V. percjelles PV-500 $\Phi$ 2.5mm2 -F.V. percjelles PV-500 $\Phi$ 4mm2 -F.V. percjelles PV-500 $\Phi$ 2x1.5 mm2 -F.V Celesa e priza 10A -F.V Celesa e priza 10A me nulifikim -F.V kuti derivacioni plastike -F.V kasete plastike KE me 12 modular (vende) -F.V automat termo/el manj.diferencial 2P 220V,32A,dl=0.03A -F.V automat termo/el manj.diferencial 2P 220V,10A -F.V automat termo/el manj.diferencial 2P 220V,16A -Celes automat termo elektro magnetik 2P;20A;220V -Llampe sinjalizimi 220v;1:2w -Priza telefonie -F.V kabell telefoni 2x0.5mm2 -F.V kabell televiziv 75 -Deviator CAD 12 -Priza televizori	0-20 mln leke	<b>2,848,540</b> leke
NS-3 A	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)	F.V ashensor me permasa (1.90m x 1.75 m) 10 kate me kapacitet mbi 450 kg I certifikuar( garanci 2 vjet)	0-20 mln leke	<b>4,500,000</b> Leke

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

*Për stafin e sipërcituar të paraqesë dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve dhe kontrata pune.*

**2.3.4** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

a. Inxhinier elektrik 1 (një)

b. Inxhinier hidroteknik 1 (një)

c. Teknik Ndërtimi 1 (një)

---

*Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/ dëshmi profesionale ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

a. Manovratorë	1 punonjës
b. Drejtues mjeti për automjetet e kërkuara	2 punonjës
c. hidraulik	1 punonjës
d. elektrikist	1 punonjës
e. hidroizolues	3 punonjës
f. murator	5 punonjës
g. bojaxhi	7 punonjës
h. hekurkthyes	5 punonjës
i. karpentiere	5 punonjës
j. Punëtor ndërtimi të thjeshtë	10 punonjës

*Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomë/dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Në rastin kur punonjësit Manovrator, drejtuesit e mjetit për automjetet e kërkuara janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të disponoje një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- **Inxhinieri e Ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve me qëllim realizimin saktë të strukturave prej betoni kryesisht kemishimeve të kolonave, vendosjes së hekurave si dhe elementeve beton arme. Ai është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit, cilësinë e materialeve konkretisht betonit dhe hekurit.
- **Inxhinieri elektrik** është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve elektrike.
- **Inxhinieri hidroteknik** është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve hidraulike.
- **Tekniku i Ndërtimit** është i nevojshëm për zbatimin e të gjitha punimeve ndërtimore në baze të zërave të preventivit duke ndjekur me përpikmëri kushtet teknike të zbatimit si dhe janë përgjegjës për koordinimin e punës në kantierët e ndërtimit.
- **Drejtuesit e mjetit** janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve transportuese si kamion dhe autobetoniere.
- **Manovratorët** janë të nevojshëm për drejtimin e mjetit fadrromë.
- **Hekurkthyesit dhe karpentieret** duhen për realizimin në vend të strukturave beton arme sipas projektit (këmishimi i kolonave dhe tokretim).
- **Hidrauliket** janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve hidraulike vendosjen e tubave të ndryshëm sipas zërave të preventivit.
- **Elektricitet** janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve elektrike instalime dhe vendosje pajisjesh në baze të zërave të preventivit
- **Muratorët** janë të nevojshëm për ndërtimin e mureve të tullave të tipeve të ndryshëm si dhe suvatimet e jashtme dhe të brendshme sipas projektit dhe zërave të preventivit.

- **Hidroizoluesit** janë te nevojshem per hidroizolimën e sipërfaqeve te tarracave apo mureve ne baze te pershkrimit ne projekt dhe zerat e preventivit.
- **Bojaxhinjtë** janë të nevojshëm për realizimin e lyerjes me bojë sipas zërit të preventivit ne gjithë sipërfaqen e llogaritur në projekt.

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 44 (dyzet e katër) persona.

Numri prej **44** punonjës përfshin **10** punëtorë të thjeshtë + **34** persona janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve, drejtues mjete, murator, hekurkthyes, karpentier, bojaxhinj të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu për llogaritjen e numrit të punonjësve janë marre parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë si dhe kontratave të ngjashme.

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji Makinerive	Sasia
Automjete vetshkarkuese me masë maksimale te autorizuar 3.5-7.5 ton	1 copë
Automjete vetshkarkuese me masë maksimale të autorizuar mbi 7.5-18 ton	1 copë
Autobetoniere	1 copë
Skela	1000 m2
Fadrome	1 copë

*Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të paraqesë: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentet si: Leja e qarkullimit, Certifikata e Kontrollit Teknik, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj).*

Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh gjithashtu edhe kombinimet e mundshme të punës se mjeteve në kantier ne te cilen eshte e shperndare puna objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme

---

*për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

*Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".*

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

### **2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata:**

a. Certifikatë: ISO 9001 - Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** *Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.*

b. Certifikatë: ISO 45001:2018 - Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** *Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.*

**Shënim:** Në rastet kur citohet në specifikimet teknike termi "Cilësia e parë, Importi" ose "Cilësi e I-rë", ky përcaktim është i barazvlefshëm me termin "ose ekuivalentë".

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: "Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit", mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të treme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

---

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhënat e mëposhtme:

**1. Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës**

Emri	Bashkia Durrës
Adresa	Sheshi "Liria", Qyteti Durrës
Tel/Fax	052 22 23 10
E-mail	<a href="mailto:info@durres.gov.al">info@durres.gov.al</a>
Faqja e Internetit	<a href="http://www.durres.gov.al">www.durres.gov.al</a>

**2. Lloji i procedurës së prokurimit:** Tender i Kufizuar (në kuadër të procesit të rindërtimit)

**3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:** "Riaftësim strukturor i Pallatit nr.15, Rruga "Abaz Çelkupa 15", Rajoni 3, Kod GIS 24795".

**4. Numri i referencës së procedurës/lotit :** REF-13604-07-18-2024

**5. Fondi / vlera e përafërt e kontratës:** 81.831.881 (tetëdhjetë e një milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e një) Lek pa TVSH.

**6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** 224 (dyqind e njëzet e katër) ditë.

**7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data: **29.07.2024** Ora: **10:00**  
Vendi: Prokurim elektronik [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**8- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Data: **29.07.2024** Ora: **10:00**  
Vendi: Prokurim elektronik [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP ([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)).

**Njësia e Prokurimit**